



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2021:154018  
Datë: 31.05.2024  
Numri i dokumentit: 05766484

C.nr.697/2021

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Avni Berisha, në çështjen juridiko-civile të paditësve V.Xh.Sh nga Prizreni dhe M.M nga Rahoveci, me përfaqësues të autorizuar avokat D.M nga Prizreni, , kundër të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale për Arsim, të cilën e përfaqëson avokati B.O nga Rahoveci, sipas autorizimit në shkresat e lëndës, për shkak të kompensimit nga marrëdhënia e punës, vlera e kontestit 1000.00 euro, jashtë seancës, me datë 31.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

KONSIDEROHET SË ËSHTË TËRHEQUR padia e paditësve V.Xh.Sh nga Prizreni dhe M.M nga Rahoveci,, lidhur me çështjen kontestimore padi për për shkak të kompensimit nga marrëdhënia e punës, vlera e kontestit 1000.00 euro.

DETYROHEN paditësit V.Xh.Sh nga Prizreni dhe M.M nga Rahoveci, që në emër të shpenzimeve të procedurës, të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, t’ia paguajë shumën prej 104.00 euro, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësit V.Xh.Sh nga Prizreni dhe M.M nga Rahoveci, përfaqësuesi të autorizuar av. D.M nga Prizreni, me datë 12.07.2021 ka paraqitur në Gjykatë padi për shkak të kompensimit nga marrëdhënia e punës, vlera e kontestit 1000.00 euro, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale për Arsim.

Gjykata gjatë shqyrtimit paraprak të padisë për kompensimin e dëmit, gjeti se paditësi e ka paguar taksën gjyqësore, por jo në lartësinë e vlerës së kontestit.

Me vërejtjen për pagesë të diferencës për taksës gjyqësore C.nr.697/21 të datës 12.02.2024, kjo gjykatë e ka ftuar paditësin që në afat prej 15 ditësh, ta paguajnë diferencën në taksën e paraparë gjyqësore për padinë e parashtruar, me vërejtje se në rast se të njëjtën nuk e paguan do të konsiderohet se e ka tërhequr padinë.

Në shkresat e lëndës ekziston prova – fletëkthesa, se përfaqësuesi i autorizuar i paditësit e ka pranuar aktvendimin e lartcekur, me datën 21.02.2024, dhe nuk ka vepruar brenda afatit të caktuar nga Gjykata.

Duke marrë parasysh faktin se as pas aktvendimit të dërguar nga gjykata, paditësi nuk e ka bërë pagesën e kësaj takse brenda afatit të përcaktuar, ndërsa që nuk ekzistojnë kushtet për lirimin e saj nga pagesa e të njëjtës, gjykata vendosi si në dispozitiv, e në pajtim me dispozitat e nenit 253 pika 5 të Ligjit nr.03/1-006 për Procedurën Kontestimore, në të cilin nen thuhet se: *“ Në qoftë se Paditësi nuk e paguan taksën gjyqësore të përcaktuar për padinë as pas vërejtjes së dërguar nga gjykata, edhe pse nuk ekzistojnë konditat për lirim nga detyrimi i pagimit të taksës gjyqësore, do të konsiderohet se padia është tërhequr ”.*

Vendimin mbi shpenzimet procedurale gjykata e mori në kuptim të nenit 452.1 të LPK-së, i cili përcakton se: *“Pala e cila e humbë procesin gjyqësor tërësisht ka për detyrë që palës kundërshtarë gjyq fituese, dhe ndërhyrësit që i është bashkuar, t’ia shpërblej të gjitha shpenzimet gjyqësore”*, në kuptim të kompensimit të shpenzimeve të palës gjyq fituese, duke vendosur që paditësi t’ia kompensojë të paditurës shumën si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, dhe atë për përgjigjes në padi shumën prej 104 euro.

Prandaj, nga ajo që u tha më lartë, kjo gjykatë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, e në bazë të nenit 253 pika 5 të LPK-së.

## GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil

C.nr.697/2021, më datën 31.05.2024

Gjyqtari  
Avni Berisha

**KËSHILLË JURDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit.